



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.598/7 prot.

Datë, 29.04.2022

V E N D I M
Nr. 393/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiovent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.04.2022 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-22148-03-16-2022, me objekt “Shërbim dezinfektimi i zonës urbane qyteti Divjakë dhe i strugave ujëmbajtëse në zonën e parkut dhe të plazhit”, me fond limit 11.666.666 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.04.2022, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.

Ankimues: “Medial” SHPK
Rruga “Siri Kodra”, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Divjakë
Lagjja nr.2, Sheshi “Santa Barbara”, Divjakë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin

dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues nuk ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.03.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Shërbim dezinfektimi i zonës urbane qyteti Divjakë dhe i strugave ujëmbajtëse në zonën e parkut dhe të plazhit*”, me fond limit 11.666.666 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.04.2022, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.

II.2. Në datën 23.03.2022 operatori ekonomik “Medial” SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Gjithashtu, nisur nga pretendimet operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatohet se operatori ekonomik “Medial” SHPK, në datë 23.03.2022 ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE), në rubrikën “Kërkesa”.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 1414/3 prot., datë 31.03.2022, protokolluar me tonën në datën 05.04.2022, me objekt *“Kthim përgjigje ankesës me Nr.1414 prot., datë 28.03.2022”*, si dhe shkresën nr. 1627/2 prot., datë 07.04.2022, protokolluar me tonën në datën 11.04.2022, me objekt *“Dërgim informacioni KPP-së lidhur me ankesën e shoqërisë ‘Medial’ ShPK”* është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e prokurimit, ku ndër të tjera, citohet: *“Në datë 28.03.2022, pranë autoritetit tonë kontraktor, është paraqitur 1 (një) ankesë, konkretisht nga shoqëria ‘Medial’ Shpk, me Nr. 1414 prot.”*.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se, ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Medial” SHPK dhe me shkresën Nr.1414/3 prot., datë 31.03.2022, e ka njoftuar atë se pretendimet e tij nuk qëndrojnë, e rrjedhimisht ankesa do të refuzohet.

II.6. Duke qenë se operatori ekonomik “Medial” SHPK ka paraqitur ankesë pranë KPP në datë 23.03.2022, por nga informacioni dhe dokumentacioni bashkëlidhur i autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka protokolluar ankesën e operatorit ekonomik “Medial” SHPK në datë 28.03.2022, KPP me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe rrethanave, me anë të shkresës nr.598/5 prot., datë 22.04.2022 i kërkoi operatorit ekonomik ankimues të paraqesë pranë KPP dokumentacionin provues që vërteton datën e dorëzimit të ankesës së tij pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 26.04.2022 është protokolluar pranë KPP me nr.598/6 prot, shkresa e operatorit ekonomik “Medial” SHPK me nr.23042022 prot., datë 23.04.2022, me objekt *“Kthim-përgjigje të shkresës me prot.598/5 datë 22.04.2022 për paraqitje provash”*, në lidhje me dokumentacionin provues të dorëzimit të ankesës pranë autoritetit kontraktor. Bashkëlidhur shkresës së

mësipërme, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar edhe dokumentin “Dëftesë Pranimi e Objekteve Postare” datë 23.03.2022, i zyrës postare në Tiranë, për objektin me KOD – BAR RR037683532AA, me dërgues “Medial” SHPK dhe marrës “Bashkia Divjakë”, dokument i cili vërteton se objekti postar është dorëzuar në zyrën postare Tiranë në datë 23.03.2022.

Gjithashtu në shkresën e mësipërme operatori ekonomik ankimues ndër të tjera citon: “[...] ...ju bën më dije se në datë 23.03.2022 kemi paraqitur në rrugë elektronike në sistemin e APP ankesën tonë si dhe po në këtë datë kemi dërguar me postë në rrugë zyrtare ankesën tonë pranë autoritetit kontraktor. [...]”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues dhe dokumentacionit provues dorëzuar nga ky i fundit, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Medial” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson të ndalet fillimisht në respektimin e kushteve formale të paraqitjes së ankesës nga ana e operatorit ekonomik ankimues njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Konkretisht KPP vëren se,

III.1.1. Në datën 17.03.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Shërbim dezinfektimi i zonës urbane qyteti Divjakë dhe i strugave ujëmbajtëse në zonën e parkut dhe të plazhit”, me fond limit 11.666.666 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.04.2022, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.

III.1.2. Në datën 23.03.2022 operatori ekonomik “Medial” SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Gjithashtu, nisur nga pretendimet operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatohet se operatori ekonomik “Medial” SHPK, në datë 23.03.2022 ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE), në rubrikën “Kërkesa”.

III.1.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të

dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

III.1.4. Nëpërmjet shkresës nr. 1414/3 prot., datë 31.03.2022, protokolluar me tonën në datën 05.04.2022, me objekt *“Kthim-përgjigje ankesës me Nr.1414 prot., datë 28.03.2022”*, si dhe shkresën nr. 1627/2 prot., datë 07.04.2022, protokolluar me tonën në datën 11.04.2022, me objekt *“Dërgim informacioni KPP-së lidhur me ankesën e shoqërisë ‘Medial’ ShPK”* është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e prokurimit, ku ndër të tjera, citohet: *“Në datë 28.03.2022, pranë autoritetit tonë kontraktor, është paraqitur 1 (një) ankesë, konkretisht nga shoqëria ‘Medial’ Shpk, me Nr. 1414 prot.”*.

III.1.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Medial” SHPK dhe me shkresën Nr.1414/3 prot., datë 31.03.2022, e ka njoftuar atë se pretendimet e tij nuk qëndrojnë, e rrjedhimisht ankesa do të refuzohet.

III.1.6. Duke qenë se operatori ekonomik “Medial” SHPK ka paraqitur ankesë pranë KPP në datë 23.03.2022, por nga informacioni dhe dokumentacioni bashkëlidhur i autoritetit kontraktor rezulton se ky i fundit ka protokolluar ankesën e operatorit ekonomik “Medial” SHPK në datë 28.03.2022, KPP me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe rrethanave, me anë të shkresës nr.598/5 prot., datë 22.04.2022 i kërkoi operatorit ekonomik ankimues të paraqesë pranë KPP dokumentacionin provues që vërteton datën e dorëzimit të ankesës së tij pranë autoritetit kontraktor.

III.1.7. Në datën 26.04.2022 është protokolluar pranë KPP me nr.598/6 prot, shkresa e operatorit ekonomik “Medial” SHPK me nr.23042022 prot., datë 23.04.2022, me objekt *“Kthim-përgjigje të shkresës me prot.598/5 datë 22.04.2022 për paraqitje provash”*, në lidhje me dokumentacionin provues të dorëzimit të ankesës pranë autoritetit kontraktor. Bashkëlidhur shkresës së mësipërme, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar edhe dokumentin “Dëftesë Pranimi e Objekteve Postare” datë 23.03.2022, i zyrës postare Tiranë, për objektin me KOD – BAR RR037683532AA, me dërgues “Medial” SHPK dhe marrës “Bashkia Divjakë”, dokument i cili vërteton se objekti postar është dorëzuar në zyrën postare Tiranë në datë 23.03.2022. Gjithashtu në shkresën e mësipërme operatori ekonomik ankimues ndër të tjera citon: *“[...] ...ju bën më dije se në datë 23.03.2022 kemi paraqitur në rrugë elektronike në sistemin e APP ankesën tonë si dhe po në këtë datë kemi dërguar me postë në rrugë zyrtare ankesën tonë pranë autoritetit kontraktor. [...]”*

III.1.8. Në nenin 110, pikat 1, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.9. Në nenin 111, pika 1 dhe 4 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1.Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.”

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të ligjit 162/2020 parashikon shprehimisht se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik”.

III.1.10. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, rezulton se, publikimi i njoftimit të kontratës është bërë në datën 17.03.2022, ndërkohë që për këtë procedurë prokurimi operatori ekonomik ankimues “Medial” SHPK, rezulton se ka paraqitur ankesë më shkrim pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datë 23.03.2022, ndërkohë që pranë autoritetit kontraktor (referuar informacionit të këtij të fundit) ankesa është protokolluar në datë 28.03.2022 jashtë afateve të ankimit.

Në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh”, i ndryshuar, parashikohet se: “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Duke qenë se operatori ekonomik “Medial” SHPK ka paraqitur ankesë pranë KPP në datë 23.03.2022, por nga informacioni dhe dokumentacioni bashkëlidhur i autoritetit kontraktor rezulton se ky i fundit ka protokolluar ankesën e operatorit ekonomik “Medial” SHPK në datë 28.03.2022, KPP me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe rrethanave, me anë të shkresës nr.598/5 prot., datë 22.04.2022 i kërkoi operatorit ekonomik ankimues të paraqesë pranë KPP dokumentacionin provues që vërteton datën e dorëzimit të ankesës së tij pranë autoritetit kontraktor.

Në datën 26.04.2022 është protokolluar pranë KPP me nr.598/6 prot, shkresa e operatorit ekonomik “Medial” SHPK me nr.23042022 prot., datë 23.04.2022, me objekt *“Kthim-përgjigje të shkresës me prot.598/5 datë 22.04.2022 për paraqitje provash”*, në lidhje me dokumentacionin provues të dorëzimit të ankesës pranë autoritetit kontraktor. Bashkëlidhur shkresës së mësipërme, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar edhe dokumentin *“Dëftesë Pranimi e Objekteve Postare”* datë 23.03.2022, të zyrës postare Tiranë, për objektin me KOD – BAR RR037683532AA, me dërgues “Medial” SHPK dhe marrës “Bashkia Divjakë”, dokument i cili vërteton se objekti postar është dorëzuar në zyrën postare Tiranë në datë 23.03.2022

Referuar informacionit dhe dokumentacionit provues (*“Dëftesë Pranimi e Objekteve Postare”* të objektit me KOD – BAR RR037683532AA) të dorëzuar nga vetë operatori ekonomik “Medial” SHPK, konstatohet se ky objekt postar është dorëzuar në zyrën postare Tiranë në datë 23.03.2022 dhe nga gjurmimi në faqen zyrtare të internetit të Postës Shqiptare, rezulton se objekti postar me KOD – BAR RR037683532AA, në datë 24.03.2022 i është dhënë postierit për dorëzim, në zyrën postare Divjakë. Pra vetë, operatori ekonomik ankimues me dokumentacionin e paraqitur provon, se ankesa është dorëzuar pranë shërbimit postar Tiranë në datë 23.03.2022 dhe ndërkohë nga verifikimi konstatohet, se në datë 24.03.2022 ka mbërritur në zyrën postare Divjakë, kur ndërkohë duhej të ishte dorëzuar pranë autoritetit kontraktor Bashkia Divjakë në datë 23.03.2022.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, sjell në vëmendje të ankimuesit nenin 111, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *“Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik”*. Në rastin konkret ankesa e operatorit ekonomik ankimues jo vetëm që nuk është dorëzuar njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, por rezulton se pranë autoritetit kontraktor kjo ankesë është dorëzuar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në nenin 110, pika 1 e LPP i cili parashikon se *“Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”*.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të kontratës 17.03.2022 dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret data e publikimit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është 17.03.2022, ndërkohë ankesa e paraqitur nga

ankimuesi pranë autoritetit kontraktor është pas datës 23.03.2022, jashtë afatit 7 ditor të përcaktuar në ligj duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Gjithashtu, vetë operatori ekonomik ankimues me dokumentacionin e paraqitur pranon se ankesa është dorëzuar pranë shërbimit postar Tiranë në datë 23.03.2022, dhe nga gjurmimi postar i dokumentit të paraqitur si provë nga ankimuesi, konstatohet se ka mbërritur në zyrën postare Divjakë në datë 24.03.2022, kur ndërkohë duhej të ishte dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në datë 23.03.2022.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj. Në rastin konkret nga provat e paraqitura nga autoriteti kontraktor, si dhe provave të paraqitura nga vetë operatori ekonomik ankimues, vërtetohet se ankesa është paraqitur pranë autoritetit kontraktor jashtë afateve të parashikuara ligjore të ankimit.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”*.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.11. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, se ka paraqitur ankesë në datën 23.03.2022 pranë autoritetit kontraktor në rrugë elektronike, në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), në rubrikën “Kërkesa”, Komisioni sjell në vëmendje se:

III.1.12. Në nenin 96 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, parashikohet:

“1. Me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimuesi, personi përgjegjës për prokurimin konfirmon në bazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik, nëse ankesa është paraqitur edhe pranë KPP-së.”

III.1.13. Në nenin 17 pika 4 dhe 5 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, parashikohet se: *“4. Ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik dorëzohen në rrugë elektronike, përveçse kur ligji ose aktet nënligjore parashikojnë ndryshe. Komisioni miraton me rregullore të brendshme funksionimin e sistemit elektronik të ankesave.*

5. Deri në vënien në funksion të plotë të sistemit elektronik të ankesave, dorëzimi dhe administrimi i tyre zhvillohet në rrugë shkresore.”

Ndërsa, në nenin 18 pika 1 parashikohet: *1. Ankesa pranohet dhe regjistrohet pranë Komisionit të Prokurimit Publik në formë shkresore ose në sistemin elektronik të ankesave.*

III.1.14. Referuar dispozitave të mësipërme, vlen të theksojmë se, që nga data 27.10.2021, me publikimin nga Komisioni i Prokurimit Publik të Sistemit Elektronik të Ankesave, ankesat mund të dorëzohen njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në formë elektronike përmes platformës unike qeveritare E-Albania, me qëllim lehtësimin e procedurës dhe transparencës në dorëzimin e ankesave nga operatorët ekonomikë. Por gjithashtu, në Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, është përcaktuar, se deri në vënien në funksion të plotë të sistemit elektronik të ankesave, dorëzimi dhe administrimi i tyre mund të zhvillohet në rrugë shkresore. Pra, aktualisht operatorët ekonomikë të interesuar në një procedurë prokurimi mund të paraqesin ankesat e tyre në lidhje me dokumentet e tenderit apo vlerësimin e procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, duke zgjedhur një nga format, nëpërmjet Sistemit Elektronik të Ankesave në platformën E-Albania, ose në formë shkresore, por në asnjë rast ligji për prokurimin publik, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, nuk parashikojnë dorëzimin e ankesave për procedurat e prokurimit publik nëpërmjet postës elektronike.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Medial” SHPK për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur”*, me Nr. REF-22148-03-16-2022, me objekt *“Shërbim dezinfektimi i zonës urbane qyteti Divjakë dhe i strugave ujëmbajtëse në zonën e parkut dhe të plazhit”*, me fond limit 11.666.666 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.04.2022, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Medial” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri